




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 40 shkronja (h) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26 shtator 2008, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që:

Në mbështetje të nenit 12, 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 e datës 04 qershor 2008, nenit 24, 25 të Ligjit Nr.06/L-092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019 nenit 4, 7 dhe 8 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010, nenit 10,11,16 dhe 26 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor, nenit 9, 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26 shtator 2008 Vendimit KK Lipjan për Miratimin e plotësimit dhe ndryshimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban të Lipjanit 15Nr.12514 dt.23.08.2013 si dhe Vendimit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Nr.A-260/18 i datës 03.09.2018, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me datë _____ 2020, të miratojë këtë:

PROPOZIM

VENDIM

PËR PARCELËN KADASTRALE P-71409044-01745-0

I.MIRATOHET, propozimi i Kryetarit të Komunës për njërën nga tri propozimet si vijon:

Propozimi nr.1

MIRATOHET propozimi që parcela kadastrale P-71409044-01745-0 në vendin e quajtur “Varosh” me sipërfaqe prej 753m² Zona Kadastrale Lipjan në pronësi të Ismajl Jahirit të përfshihet në plotësim dhe ndryshim të Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban të Lipjanit 15Nr.12514 dt.23.08.2013.

Obligohet Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që parcelën kadastrale nr.01745-0 Zona Kadastrale Lipjan të cekur në paragrafin paraprak ta përfshijë në ndryshimet në Planin Zhvillimor Komunal dhe kushtet e përcaktuara në dokumentet e ardhshme të planifikimit hapësinor – Harta Zonale e Komunës dhe të zhvillojë procedurat e nevojshme që parashifen për procesin e Lejes ndërtimore sipas legjislacionit në fuqi.

Propozimi nr.2

MIRATOHET propozimi për shpalljen e interesit publik për shpronësim të paluajtshmerisë për realizimin e Planit Zhvillimor Komunal, Planit Rregullues Urban "Qendra" për implementimin e projektit Sheshi "Adem Jashari" në Lipjan dhe kjo i shërben shfrytëzimit për qëllime të interesit publik të komunës për pjesën e parcelës kadastrale P-71409044-01745-0 në vendin e quajtur "Varosh" me sipërfaqe prej 600m², Zona kadastrale Lipjan në pronësi të pronarit Ismajl Jahirit nga Lipjani sipas dispozitave të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010.

Obligohet Komuna e Lipjanit të bëjë kompensimin për pjesën e pronës së shpronësuar, bazuar në Akt-Vlerësimin të datës 21.05.2019 të Ministrisë së Financave-Departamenti i Tatimit në Pronë, sipërfaqja prej 600m² të parcelës 1745-0 në pronësi të Ismajl Jahirit, për vlerësim m² çmimi i tokës (€/m²) 650.00 totali në (€) 390,000.00.

Propozimi nr.3

MIRATOHET propozimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarit Ismajl Jahirit nga Lipjani.

-Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim është pjesë e parcelës kadastrale P-71409044-01823-1 në vendin e quajtur "Varosh" me sipërfaqe prej 1529m² Zona kadastrale Lipjan e evidentuar pronë shoqërore e destinuar Zonë banimi kolektiv në kuadër të Zonës Urbane "Qendra".

-Prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim është pjesa e parcelës kadastrale P-71409044-01745-0 në vendin e quajtur "Varosh" me sipërfaqe prej 600m², Zona kadastrale Lipjan në pronësi të pronarit Ismajl Jahirit nga Lipjani.

Bazuar në Akt-Vlerësimin të datës 21.05.2019 të Ministrisë së Financave-Departamenti i Tatimit në Pronë, sipërfaqja prej 600m² të parcelës 1745-0 në pronësi të Ismajl Jahirit, për vlerësim m² çmimi i tokës (€/m²) 650.00 totali në (€) 390,000.00, ndërsa sipërfaqja prej 6343 m² e pronës komunale 1823-1 për vlerësim m² çmimi i tokës (€/m²) 255.00 totali në (€) 1,617.465.00.

II. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra e Kryetarit-Sektori pronësor-juridik, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

III. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës Lipjan 15Nr.463-76615 i datës 26.12.2018 .

IV. Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij propozim-vendimi është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144, Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010, të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor, të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26 shtator 2008, Vendimit KK Lipjan për Miratimin e plotësimit dhe ndryshimit të Planit zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor urban të Lipjanit 15Nr.12514 dt.23.08.2013 si dhe Vendimit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Nr.A-260/18 i datës 03.09.2018.

Bazuar në Akt-Vlerësimin të datës 21.05.2019 të Ministrisë së Financave- Departamenti i Tatimit në Pronë, janë vlerësuar pranat e komunale dhe prona private si vijon:

Sipërfaqja prej 6343 m² e pronës komunale 1823-1 për vlerësim m² çmimi i tokës (€/m²) 255.00 totali në (€) 1,617.465.00.

Sipërfaqja prej 4169 m² e pronës komunale 1252-7 për vlerësim m² çmimi i tokës (€/m²) 58.00 totali në (€) 241,802.00.

Sipërfaqja prej 1253 m² e pronës komunale 1188-3 për vlerësim m² çmimi i tokës (€/m²) 92.00 totali në (€) 115,276.00

Sipërfaqja prej 600m² të parcelës 1745-0 në pronësi të Ismajl Jahirit, për vlerësim m² çmimi i tokës (€/m²) 650.00 totali në (€) 390,000.00.

Bazuar në Akt-Vlerësimet të prezentuara në tabelë me të dhënat sipas elaboratit/ fletës përduese parcela 1745-0 në pronësi të Ismajl (Mustafë) Jahirit me sipërfaqe për vlerësim prej 600m² për një (ari) çmimi i tokës është llogaritur në shumën 650.00 € m² ku i bie që për këmbim për sipërfaqen e cekur në pjesën në të cilën është e koncentruar parcela kadastrale 1823-1 e cila gjendet në kuadër të zonës së njëjtë (Qendra) është llogaritur 255.00 € m², ndërsa parcelat kadastrale 1252-7 dhe 1188-3 janë vlerësuar shumë ulët duke u bazuar në vlerën e tregut në këto zona.

Me Vendimin 1Nr.463-37263 datë 06.06.2019 të Kryetarit të Komunës së Lipjanit, grupi punues për hartimin e propozim-vendimit, ka shqyrtuar dokumentacionin e prezentuar nga Ministria e Financave-Departamenti i Tatimit në Pronë për vlerësimin të pronës së paluajtshme dhe ka konstatuar se Akt-Vlerësimet për pronat e paluajtshme 1745-0,1252-7,1823-1 dhe 1188-3 të cilat janë objekt këmbimi konform Vendimit të Kuvendit të Komunës 15Nr.463-76615 e datës 26.12.2018 nuk janë në harmoni në vlerën e tregut dhe me shkresën e datës 10.06.2019 ref 1-463-35790, grupi punues ka kërkuar rivlerësim të pronës së paluajtshme nga Departamenti i Tatimit në Pronë pranë Ministrisë së Financave dhe në përgjigjen -shkresën e MF 09 Nr.120-4 prot. datë 20.06.2019 për rivlerësim të pronës konstatohet se pronat e cekura janë vlerësuar konform dispozitave ligjore në fuqi.

Komuna e Lipjanit pas marrjes së Përgjigjes nga Ministria e Financave të cekur në paragrafin paraprak zyrtarisht ka kontestuar çmimin e tokës në procedurë gjyqësore.

Me Aktvendimin CN.nr.28/2019 datë 05.09.2019 Gjykata Themelore–Dega në Lipjan-departamenti përgjithshëm-divizioni civilil Shpallet inkompetente në pikpamje lëndore për të gjykuar në këtë çështje juridike, ndërsa në Aktvendimin Ac.nr.6122/19 të Gjykatës së Apelit të

Kosovës në Prishtinë datë 21.01.2020 refuzohet e pa themeltë ankesa e propozueses Komuna e Lipjanit, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, CN.nr.28/2019 të datës 05.09.2019 vërtetohet, me arsytimin se departamenti i cili e ka vlerësuar pronën në fjalë është në kompetencë ligjore nga ana e Qeverisë- Ministrisë së Financave, Departamenti i Tatimit në Pronë dhe çështja në fjalë duhet të zgjidhet në procedurë administrative dhe ky departament tani ka kompetencë ekskluzive për vlerësimin e pronës.

Bazuar në këto të dhëna duke analizuar kushtet e vlerësimit – tabelat e prezentuara konstatohet se parcela e vlerësuar në zonë të njëjtë “Qendra” rezulton në raport 1:2.5 (600m²/1529m²).

Propozimi nr. 1, si në pikën I të këtij propozim-Vendimi propozohet duke u bazuar në shkresën e datës 20.11.2018 ref.1-350-53287/2 të Drejtoratit për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit me të cilën na njofton se është në proces të hartimit të dokumentit të planifikimit-Harta Zonale e Komunës sipas së cilës definohej kushtet e përgjithshme dhe kushtet specifike të zhvillimit dhe shfrytëzimit të hapësirës në nivel të parcelës dhe njëkohësisht obligohet DPUMM-ja që të përfshijë ndryshimet e parcelës dhe kushtet e prcaktuara në dokumentet e ardhshme të planifikimit hapësinor – Harta Zonale e Komunës, si dhe procedurat që parashifen për procesin e Lejes ndërtimore sipas legjislacionit në fuqi.

Propozim nr.2, shpronësimi siç përcaktohet në pikën I të këtij propozim –Vendimi, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Vendimin e fundit Nr.A-260/18 datë 03.09.2018 dhe në të gjitha Vendimet tjera ka theksuar që mungon një Vendim i marrë nga Komuna për fillimin e procedurave të shpronësimit i cili do ta arsyetonte interesin publik lidhur me parcelën 1745-0, si dhe duke u bazuar në Planin Zhvillimor Urban dhe Planin Rregullues “Qendra” të miratuar me Vendimin INr.350-521 të datës 29.05.2009, nga Kuvendi Komunal i Lipjanit, parcela e cekur më lartë ka destinim banim kolektiv, afarizëm, tregti, administratë dhe funksione përcjellëse (parking,garazhim,hapësira për lojra të fëmijeve, sipërfaqe të gjelbruara), ndërsa sipas Certifikatës mbi të dhënat kadastrale dhe kopjes së planit parcela ka hapësirë prej 753m², poashtu ka theksuar se ka hapësirë të mjaftushme për lëshimin e kushteve ndërtimore.

Propozimi nr.3, prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim sipas pikës I të këtij propozim-vendimi është pjesa e parcelës kadastrale P-71409044-01745-0 në vendin e quajtur “Varosh” me sipërfaqe prej 600m², Zona kadastrale Lipjan në pronësi të pronarit Ismajl Jahirit nga Lipjani, ndërsa prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim bazuar në Akt-Vlerësimin e cekur më lartë është pjesa e parcelës kadastrale P-71409044-01823-1 në vendin e quajtur “Varosh” me sipërfaqe prej 1529m² Zona kadastrale Lipjan e evidentuar pronë shoqërore e destinuar Zonë banimi kolektiv në etazhitet max B+P+8 (PZHU fq.159 Harta Nr.33) në kuadër të Zonës Urbane “Qendra”.


Prandaj bazuar në arsyet e theksuara më lartë, në pajtim me dispozitat e cekura ligjore kërkojmë nga kuvendi komunal miratimin e njëres prej 3 propozimeve të këtij propozim-Vendimi.

INr. 463 - 9941
Lipjan, Më 18-02.2020

KRYETARI I KOMUNES

Imri Ahmeti





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Stalhog Sekretara/Office of the Permanent Secretary

Nr. A-260/18,
Datë: 03.09.2018

Bazuar në neni 157 të Ligjit Nr. 05/L-031 datë 25.05.2016 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe në bazë të nenit 136 nën b të Ligjit Nr. 02/L-28 datë 22.07.2005 për Procedurën Administrative, përkitazi me ankesën e paraqitur nga Ismail Jahiri, rruga „Prilli 99”, nga fshati Sillovi, Lipjan, të ushtruar kundër Aktvendimit Nr. 8-350-39476, datë 12.07.2018, të Drejtorisë për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna Lipjan, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nxjerr:

V E N D I M

Shfuqizohet Aktvendimi Nr. 8-350-39476, datë 12.07.2018, i Drejtorisë për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna e Lipjanit.

Lënda kthehet në rishqyrtim.

A r s y e t i m

Me Aktvendimin Nr. 8-350-39476, datë 12.07.2018, Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna e Lipjanit, ka refuzuar kërkesën e Ismail Jahirit nga Lipjani, për caktimin e kushteve ndërtimore, me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve ndërtimore për ndërtimin e objektit afarist banesor me etazhitet B+P+6, në parcelën kadastrale P-71409044-01745-0, në sipërfaqe prej $S=753.00m^2$, e regjistruar në certifikatën e njësisë kadastrale Nr. 24128/2017, Zona Kadastrale Lipjan, rruga “Skënderbeu”, blloku urban “G3”, Lipjan.

Ismail Jahiri, nga Lipjani, ka ushtruar ankesë kundër Aktvendimit Nr. 8-350-39476, datë 12.07.2018, të Drejtorisë për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna e Lipjanit, për shkak të mos aplikimit të dispozitave të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative, shkeljes së dispozitave të drejtës materiale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet ankesa e ushtruar kundër aktvendimit Nr. 8-350-39476, datë 12.07.2018, të anulohet Aktvendimi i ankimuar dhe të nxjerrë vendim meritor në këtë çështje.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe administrimit të provave u konstatua se organi i shkallës së parë, nuk ka vendos në mënyrë të drejtë për çështjen administrative-juridike, nuk ka asnjë dëshmi të re me të cilin organi i shkallës së dytë mund të vërtetoj vendimin e Drejtorisë për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, të Komuna së Lipjanit, prandaj organi i shkallës së parë, nuk ka arsyetuar vendimet e veta sipas rekomandimeve të vendimeve Nr.A-181/17 datë 26.09.2017, Nr.A-361/17 datë 26.09.2017 dhe të vendimit Nr.A-90/18 datë 08.06.2018, të shkallës së dytë përkitazi me këtë çështje administrativo-juridike.

Bazuar në Planin Zhvillimor Urban dhe Planin Rregullues "Qendra" të miratuar me Vendimin INr. 350-521 datë 29.05.2009, nga Kuvendi Komunal i Lipjanit, parcela kadastrale P-71409044-01745-0, ka destinim banim kolektiv, afarizëm, tregti, administratë dhe funksione përcjellëse (parking, garazhim, hapësira për lojëra të fëmijëve, sipërfaqe të gjelbëruara), ndërsa sipas Çertifikatës mbi të dhënat kadastrale dhe Kopjes së planit parcela ka hapësirë prej 753 m2, e cila hapësirë është e mjaftueshme për lëshimin e kushteve ndërtimore.

Prandaj, organi i shkallës së dytë, me vendim e kthen lëndën në rishqyrtim për arsye se: në shkresat e lëndës nuk ka asnjë vendim nga Komuna e Lipjanit me të cilën është paraparë që parcela në fjalë është e inkorporuar në sipërfaqen e sheshit "Adem Jashari", në qofte se kjo parcela është paraparë për ndërtimin e sheshit atëherë organet komunale të Lipjanit është dashtë ta shpallin zonë me interes publik dhe të fillohet procedura e shpronësimit konform nenit 4 të Ligjit për Shpronësimit dhe të shpronësohet parcela nr. 01745-0, ZK Lipjan.

Në rishqyrtim, organi i shkallës së parë, duhet të veproj sipas vendimit të shkallës së dytë, ose nëse palët nuk janë të kënaqur me vendimin e organit të shkallës së dytë atëherë të hap konflikt administrativ me padi në gjykatën Kompetente.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzim juridik: Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit.

T'i dërgohet:

- Palës,
- DPUMM, KK Lipjan,
- Arkivit të MMPH-së,
- Në shkresat e lëndës

Sekretari i Përgjithshëm

Arben Çitaku



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVO / GOVERNMENT OF KOSOVO
Ministria e Financave – Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance
Departamenti i Tatimit në Pronë

Komuna: Lipjan Zona Kadastrale: Lipjan

Komuna: Lipjan									
Zona Kadastrale: Lipjan						Vlerësimi			
Të dhënat sipas Elaboratit / Fletës Poseduese									
Nr.	Pronar	Numri i pronës	Lloji i shfrytëzimit të pronës/klasa e kualitetit	Sipërfaqja e Përgjithshme m ²	Sipërfaqja për vlerësim m ²	Çmimi i tokës (€ /m ²)	Vlera për dru pyjor dhe frutor (€)	Vlera e Investimit (€)	Totali (€)
1	P.S.H. e Kuvendit Komunal Lipjan	1252-7	Livadh i klasës 2	4169	4169	58.00			241,802.00
2	P.S.H. e Kuvendit Komunal Lipjan	1823-1	Tokë Ndërtimore, Oborr Shtëpi-Ndërtëse	6343	6343	255.00			1,617,465.00
3	P.S.H. e Kuvendit Komunal Lipjan	1188-3	Kullosë e klasës 1	1253	1253	92.00			115,276.00



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVO / GOVERNMENT OF KOSOVO
Ministria e Financave – Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance

Departamenti i Tërmit në Pronë

Komuna: Lipjan Zona Kadastrale: Lipjan

Nivellimi: Liplan									
Zona kadastrale: Liplan									
Të dhënat sipas Elaboratit / Fletës Poseeduese						Vlerësimi			
Nr.	Pronar	Numri i pronës	Lloji i shfrytëzimit të pronës/klasa e kualitetit	Sipërfaqja e Përgjithshme m ²	Sipërfaqja për vlerësim m ²	Çmimi i tokës (€ /m ²)	Vlera për dru pyjor dhe frutor (€)	Vlera e Investimit (€)	Totali (€)
1	Ismail (Mustafë) Jahiri	1745-0	Tokë Ndërtimore, Oborr Shëpi-Ndërtuese	753	600	650.00			390.000,00



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR / MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA / MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGJENCIA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71409044-01823-1

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 556/2020
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 14.02.2020 - 09:03
Komuna / Opština / Municipality: Lipjan / Lipjan / Lipjan
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: LIPJAN / LIPJAN / LYPJAN
Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: Lipjan / Lipjan / Lipjan

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71409044-01823-1	PARCELË / PARCELA / PARCEL	/ /	Urban	6343			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivaliste - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address Details	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
VAROSH/VAROSH/VAROSH		VAROSH		

1. LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Nr. i Identifikimit / Parcel Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area
	Tokë Ndërtimore/Gradjevinsko zemljište/Construction land	Oborr/Dvoršte/Back Yard		5585
	Tokë Ndërtimore/Gradjevinsko zemljište/Construction land	Shëpi-Ndërtese/Kuca-Zgrada/House-Building		758

3. 'RONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licent broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhurnuar Ažurirano Updated
Sim individual / Idiataha Drzavina / Individual possessor	P.SH. E KUVENDIT KOMUNAL LIPJAN	KCID1416817	LIPJAN / LIPLJAN / LYPJAN /		LIPLJAN	1/1		



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : LIPJAN

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Lipjan

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m2
P-71409044-01823-1	Parcelë / Parcela / Parcel	6343,0



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1074

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 14.02.2020

Koha/ Vreme/ Time: 09:20:15

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:



Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR /MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71409044-01745-0

Nr. i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 556/2020
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 14.02.2020 - 09:02
Lipjan / Lipjan / Lipjan
LIPJAN / LIPJAN / LYPJAN
Zyrtar i Kadastrale Komunele / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: Lipjan / Lipjan / Lipjan

TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71409044-01745-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shogërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Urban	753	35-96		

ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivaliste - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address Details	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
VAROSH/VAROSH/VAROSH		VAROSH		

A. LLOJIT I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Nr. i bllokut / Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës / Vrstja koriscenja parcelle / Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës / Trenutno koriscenje parcelle / Parcel Current Use	Kualiteti i klasës / Kvalitet klase / Quality Class	Sipërfaqja (m²) / Povišina (m²) / Area
	Tokë Ndërtimore/Građevinsko zemljište/Construction land	Shtëpi-Ndërtese/Kuca-Zgrada/House-Building		423
	Tokë Ndërtimore/Građevinsko zemljište/Construction land	Oborr/Dvorište/Back Yard		330

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat / Prava / Rights	Emri i me / Name	Nr. person / Licent broj / ID. No.	Vendbanimi / Prebivaliste / Resident	Kodi postar / Poštanski kod / Postal code	Hollësitë e adresës / Pojednosti adrese / Address details	Pjesa e pronës / Deo inovine / Share quota	Pershkrimi / Opis / Description	Azhurnar / Ažurirano / Updated
Person individual / Osoba fizička / Individual possessor	JAHIRI ISMAIL (MUSTAFA)	1015668543	SLOVOI / SLOVINJE / SLOVNIJE /		PRILLI 99	1/1	35-96 ak.kad. nr.9-464-26197 kon.lrp.1207 nr.ref.346/2015 n.Z. Aliu	04.06.2015



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : LIPJAN

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Lipjan

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m2
P-71409044-01745-0	Parcelë / Parcela / Parcel	753,0



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1000

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 14.02.2020

Koha/ Vreme/ Time: 09:11:26

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:



Aprovot/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture: